

VENDIM
Nr. 668, datë 15.11.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË NDODHET NËN OBJEKTIN “KISHA E SHËN
PIUT X”, ELBASAN, DHE PËR KALIMIN NË PRONËSI, PA SHPËRBLIM, TË
SIPËRFAQES SË TRUALLIT KISHËS KATOLIKE SHQIPTARE, NË ZBATIM TË
MARRËVESHJES SË LIDHUR NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
SELISË SË SHENJTË PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË NDËRSJELLA,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 8902,
DATË 23.5.2002**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8, të ligjit nr. 8902, datë 23.5.2002, “Për ratifikimin e marrëveshjes së lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, të neneve 5, pika 1, 8, shkronja “dh”, dhe 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të neneve 3, shkronja “b”, dhe 4, shkronja “ç”, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, dhe të neneve 761 e vijuese, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që ndodhet nën objektin “Kisha e Shën Piut X”, Elbasan, dhe për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të sipërfaqes së truallit Kishës Katolike Shqiptare, në zbatim të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella, ratifikuar me ligjin nr. 8902, datë 23.5.2002.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “tokë truall”, me sipërfaqe 5 000 m², pjesë e pasurisë së paluajtshme me nr. 28/28, volum 2, faqe 226, zona kadastrale nr. 8525, Elbasan, me një vlerë të përgjithshme prej 70 960 000 (shtatëdhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 70 960 000 (shtatëdhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga llogaria e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale të shpronësimit, në vlerën 2 000 000 (dy milionë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e pasurisë, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

8. Pas përfundimit të procedurave të shpronësimit të bëhet kalimi në pronësi, pa shpërblim, i pasurisë tokë truall, me sipërfaqe 5 000 m², pjesë e pasurisë së paluajtshme me nr. 28/28, volum 2, faqe 226, zona kadastrale nr. 8525, Elbasan, në favor të Kishës Katolike Shqiptare, në zbatim të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella, ratifikuar me ligjin nr. 8902, datë 23.5.2002.

9. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan të realizojnë regjistrimin e kësaj pasurie në favor të subjektit Kisha Katolike Shqiptare.

10. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kisha Katolike Shqiptare, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

DATABAZË E PRONARËVE DHE MASA E SHPËRBLIMIT PËR PASURITË E PALUAJTSHME

TË DHËNAT E PRONARIT DHE TË PASURISË SË PALUAJTSHME (sipas konfirmimit zyrtar)													
NR.	EMËR	MBIEMËR	STATUSI JURIDIK					TË DHËNAT PËR SHPËRBLIMIN					
			DATA E LËSHIMIT	SIP. E PRONËS (m²)	ZONA KADASTRALE/REGJ. HIPOTEKOR	NR. I PASURISË	NR. I SUBJEKTEVE	SIP. TOTALE E PASURISË PËR SHPRONËSIM m²	PJESËT TAKUESE	SIP. TAKUESE PËR SHPËRBLIM	VENDNDODHJA E PASURISË (Zona Kadastrale)	VLERA E TREGUT PËR TRUALL (lekë/m²)	VLERA E SHPËRBLIMIT (lekë)
NR.	1	2	3	4	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1	Teuta	Pora	03.12.2012	5700	8525-766	28/28	1	5000	6/60	500	8525	14,192.000	7,096,000
2	Nebi	Sefa					1		3/60	250			3,548,000
3	Hajali	Ypi					1		3/60	250			3,548,000
4	Xhaneta	Prodani					1		3/60	250			3,548,000
5	Suhela	Libohova					1		3/60	250			3,548,000
6	Bulent	Tela					1		3/60	250			3,548,000
7	Agron	Tela					1		3/60	250			3,548,000
8	Edmond	Tela					1		3/60	250			3,548,000
9	Nesfije	Selenica					1		3/60	250			3,548,000
10	Gjerak	Karaiskaj					1		6/60	500			7,096,000
11	Felaton	Karaiskaj					1		6/60	500			7,096,000
12	Shasivar	Karaosmani					1		4/60	333.3333333			4,730,667
13	Shagushe	Kosova					1		4/60	333.3333333			4,730,667
14	Anita	Alicka					1		4/60	333.3333333			4,730,667
15	Lavdiqe	Kalasa					1		6/60	500			7,096,000
										5000			70,960,000